







Si e zbulon gjuhën fëmija im:

Për zbulimin e gjuhës janë të rëndësishëm tre faktorë:

1. Aftësia për të imagjinuar diçka që nuk ekziston: **Riprezantim** >
Ballafaqimi me botën e objekteve (**UNË – OBJEKTI**)
2. Nje lidhje stabile dhe dëshirën t'i thuash diçka tjetrit: **Komunikimi** >
Ballafaqimi me botën njerëzore (**UNË – TI**)
3. Të dish që fjalët janë të lidhura me diçka konkrete: **Kuptimi i gjuhës** >
Lidhja e botës njerëzore me objektet (**UNË – TI – OBJEKTI**)

	UNË – OBJEKTI	UNË – TI – OBJEKTI	UNË – TI
9 – 12 Muaj	<p>Përvojat shqisore</p>  <p>Çdo gjë është emocionuese! Eksplorimi i botës me të gjitha shqisat është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e gjuhës.</p>	<p>Kontakt trëkëndësh me sy</p>  <p>Fëmija shikon, çfarë bën mamaja me një objekt apo një ngjarje. Kështu ai mëson të lidhë fjalët me objektet dhe veprimet.</p>	<p>Lëvizja autonome</p>  <p>Duke u zvarritur fëmija fillon të zbulojë vetë botën e tij. Kështu ai mëson të largohet dhe të përfetojë ndjenjën e të qenit i ndarë nga mamaja.</p>
12 – 24 Muaj	<p>Loja funksionale dhe të lënit gjurmë</p>  <p>Fëmija mëson t'i përdorë gjërat sipas funksionit të tyre dhe bën një zbulim të rëndësishëm: Ai mund të lërë gjurmë me aktivitetet e tij dhe t'u japë këtyre një kuptim.</p>	<p>Ai kupton dhe flet fjalët e para</p>  <p>Fëmija fillon të kuptojë lidhjen mes fjalëve që dëgjon dhe kuptimit të tyre. Ai mëson të kuptojë dhe të flasë fjalët e para. Dhe ai zbulon se mund të shkaktojë diçka me këto fjalë. Ai shikon librat dhe kupton se figurat paraqesin diçka.</p>	<p>Hapat e para dhe "JO"</p>  <p>Fëmija hulumton botën dhe ballafaqohet gjithnjë e më shpesh me fjalën "jo". Kështu ai mëson se të tjerët nuk e dinë automatikisht se çfarë do ai. Ai duhet të komunikojë nevojat e tij! Dhe meqë është aq interesante, fëmija fillon edhe vetë të thotë "jo". Ai zbulon se mund të ndryshojë botën me gjuhën e tij.</p>

	UNË - OBJEKTI	UNË - TI - OBJEKTI	UNË - TI
24-36 Muaj	<p>Zhvillimi i koncepteve dhe lojërave simbolike</p>  <p>Fëmija zhvillon idetë e tij fillestare dhe u referohet në lojë gjërave që i ka njohur këtu dhe aty. Ai mund të lidhë veprimet e thjeshta simbolike me pasojat që ato shkaktojnë dhe gjithashtu të bëjë lidhje midis imazheve (p.sh. në libra).</p>	<p>Ndërtimi i gjuhës</p>  <p>Fëmija fillon të pyesë (Ç'është kjo? Ku është kjo?) dhe zgjeron në mënyrë të shpejtë fjalorin e tij. Ai tani mund të lidhë disa fjalë dhe të krijojë fjali.</p>	<p>Zbulimi i "UNË"</p>  <p>Fëmija njeh veten në pasqyrë, di tashmë emrin e tij, dhe thotë edhe "UNË". Ai kënaqet kur arrin diçka, por kupton edhe vështirësitë që i dalin rrugës dhe mund edhe të nxehet shumë.</p>
Ab 36 Muaj	<p>Lojëra me role</p>  <p>Fëmija mund të imagjinojë ngjarjet të tëra dhe te organizojë një lojë të caktuar: Ai kërkon gjërat që i duhen dhe mund të zëvendësojë diçka me diçka tjetër që i mungon.</p>	<p>Kuptojnë dhe tregojnë histori</p>  <p>Fëmija fillon të kuptojë marrëdhëniet midis ngjarjeve dhe pyet "Pse?". Ai mund të kuptojë histori të thjeshta nga librat me figura dhe të tregojë përjetimet e tij.</p>	<p>Zbulimi i NE Lojë me moshataret</p>  <p>Në kontakt me moshatarët e tij fëmija nuk është më i varur nga mbështetja e një të rrituri të besuar. Ai mund të luajë në mënyrë të pavarur me shokët e tij dhe të bëjë biseda me ta.</p>

Si mund ta mbështes fëmijën tim?

- **Loja:** Lëreni fëmijën të provojë, te hulumtojë, vetëm dhe me fëmijët e tjerë. Angazhoheni në lojëra simbolike dhe me role të ndryshme dhe mbështeteni atë: Ju vetë jeni më të rëndësishëm për zhvillimin e gjuhës së tij për të sesa Dominos ose puzzles.
- **Dëgjoni, bëni pyetje dhe shpjegoni botën:** Dëgjojeni fëmijën dhe bëni pyetje reale. Dëgjoni me vëmendje se çfarë kupton, me çfarë merret dhe për çfarë flet fëmija juaj. Mos i flisni vetëm ju pa pushim.
- **UNË dhe TI:** Balafaqohuni me fëmijën si TI. Ndhmojeni në pavarësinë dhe kokëfortësinë e tij, por vini dhe kufij me një JO të qartë.

Ky tekst është zhvilluar për këshillimin e prindërve në kuadër të projekteve të leximit të SIKJM, Zyrih (www.sikjm.ch) dhe situatave të tjera të këshillimit (Këshillëtoreve logopedike, klinikave të fëmijëve, ofertave të këshillimit që në muajt e parë të jetës). Në bashkëpunim me Dr. Barbara Zollinger nga qendra për fëmijët e vegjël, Winterthur (www.kinder.ch)